

RAPORTI I AUDITIT TE PAVARUR

Per krijimin e te ardhurave dhe shpenzimet e kryera nga PRDSH per fushaten e zgjedhjeve te dates 28 Qershor 2009

Drejtuar Komisionit Qendror te Zgjedhjeve
Tirane

Zoterinje te nderuar !

Ne ekzekutim te misionit qe me eshte besuar prej jush , kam nderin t`ju paraqes raportin mbi pasqyrimin e te ardhurave dhe shpenzimeve te Partise per Reforma Demokratike Shqiptare , ne fushaten e zgjedhjeve te 28 Qeshorit 2009 , sipas analizes bashkelidhur.

PERGJEGJESIT RESPEKTIVE

Pergjegjesia per pergatitjen e ketyre pasqyrave financiare eshte e drejtimit te Partise , te cilet mbajne pergjegjesite e plota per saktesine e tyre. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendeshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare pa anomali , zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel.

PERGJEGJESIA E AUDITUESIT

Eshte pergjegjesia ime si audit i pavarur , te shpreh nje opinion te arsyeshem mbi keto pasqyra , duke u mbeshtetur ne Standartet Nderkombetare te Auditimit , ne normat dhe kerkesat e profesionit , kerkesat e vecanta qe ka Kodi Zgjedhor I Republikes se Shqiperise , per te marre nje siguri te arsyeshme , nese pasqyrat nuk kane anomali materiale dhe ta raportoj ate para jush si dhe ne zbatimin e SKK.

Auditimi ka perfshire kryerjen e procedurave per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga audituesi , perfshire ketu edhe vlersimin mbi gjykimet dhe metodat e perdorura nga ana e Partise ne pergatitjen e ketyre pasqyrave, ne perputhje me vecorite specifike te saj.

Ai eshte mbeshtetur mbi informacionet dhe shpjegimet e vena ne dispozicion pa asnje rezerve nga ana e Partise, ne testimet e kryera , te konsideruara te mjaftushme per mbeshtetjen e opinionit mbi keto pasqyra , te cilat i sherbejne nje qellimi specifik.

Ne formimin e opinionit te auditit u vlersua gjithashtu dhe saketesia e prezantimit te informacionit.

Ne cmojme se auditimi i kryer perben nje baze te arsyeshme per te shprehur opinionin e pavarur.

OPINIONI

Bazuar ne auditimin e kryer , me siguri te arsyeshme , sipas opinionit tim si audit, pasqyrat financiare per te ardhurat dhe shpenzimet e Partise se Reformave Demokratike Shqiptare ,ne fushaten zgjedhore per Kuvendin e Shqiperise, te vitit 2009, japin nje pamje reale, te vertete dhe te sinqerte, me perjashtim te faktit qe keto pasqyra nuk jane pergatitura ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit.

Audit i Pavarur

Qani Kajo

Tirane me 31.10. 2009

**PARTIA E REFORMAVE DEMOKRATIKE SHQIPTARE
TIRANE**

SHENIME MBI DEKLARIMET FINANCIARE TE FUSHATES ZGJEDHORE TE VITIT 2009

Fushata per zgjedhjet ne Kuvendin e Shqiperise ka filluar ne date 25 Maj 2009 dhe ka mbaruar ne 28 Qershor 2009. Pasqyrat financiare e te ardhurave e shpenzimeve per periudhen e fushates per kete Parti , nuk mund te jete plotesisht e sakte dhe te prera vetem per periudhen qe u auditua , sepse kjo Parti nuk ka struktura te plotesuara per administrimin financiar , megjithate u gjeten te dokumentuara ne menyre te thjeshtuar per kete qellim , disa dokumenta , sic jane: Mandate

arktime te dhuruesve qe kishin dhene ndihma Partise , mandate per te hyra te tjera , mandate pagesa per shpenzimet e kryera te shoqeruara me fatura shpenzimesh , etj.

Nga auditimi ketyre dokumentave konstatova:

- 1. Kjo Parti nuk ka perfituar fonde nga buxheti i shtetit per kete fushate zgjedhore.**
- 2. Partia i ka pasur burimet e financimit te saj nga kontributet e antaresise ne formen e kuotizacioneve , nga dhuratat e antareve , simpatizanteve dhe vecanrisht nga kontributet e Kandidateve per Deputet ne Kuvendin e Shqiperise sipas zonave te tyre elektorale.**
- 3. Partia kishte hapur llogari te posacme per fondet e fushates se zgjedhjeve.**
- 4. Kontabiliteti per financat e Partise nuk ishte mbajtur me formen e plote sipas SKK por vetem ne menyre te thjeshtuar te ardhura e shpenzime.**

Une auditova pasqyren e te ardhurave e shpenzimeve te seline Qendrore te Partise , sepse kjo parti ishte ndertuar vetem ne menyre vertikale , pra nuk kishte dege te saj te organizuara ne rrethe te tjera me financa me vehte dhe se fundmi u hartua pasqyra permbledhese te fushates.

nr	Pershkrimi dhurimit	Shuma	Data e dhurimit	Logaria e depozituar
I-	Te ardhurat e Partise			
1	Qendra e dega Tirane	1150000	28.05-24-06	Cash ne arke
3	Shuma e te ardhurave	1150000		
II-	Shpenzimet e kryera			
1	Shpenzimet e kryera ne telefona ,kancileri ,postera bluza etj	656500	01.06.2009	Cash ne arke
2	Shpenzime te ndryshme si flamuj , kemgetare , mjete transporti levizese , spote etj	493500	01.06-28.06	Cash nga arka
	Shuma e shpenzimeve	1150000		
	Gjendje banke ose arke	0		

Keto te ardhura e shpenzime ishin te regjistruar ne librin e arkës dhe ishin shoqeruara me fatura. Njekohsisht u hartuan edhe listat me dhuruesit e fondeve. Ne baze te ligjit emrat e dhuruesve me shuma me te vogla se 100000 leke nuk u identifikuan por u lane si shume totale

Libri i dhuruesve nuk ishte mbajtur i vecante sipas ligjit megjithese te gjitha hyrat ishin evidentuar

Ne kushtet e mesiperme une formova opinionin tim si audit i pavarur se , PRDSH , me perjashtim te moszbatimit te plote te ligjit 9228 date 28.04.2004 "Per kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare" , ka pasqyruar sakte te ardhurat dhe shpenzimet per fushaten e zgjedhjeve per Kuvendin e Shqiperise te vitit 2009 ne baze te Kodit Zgjedhor te Republikes se Shqiperise si dhe vendimeve e udhzimeve te vecanta te KQZ-se

Tirane me 31.10.2009

Audit i Pavarur

Qani Kajo